

INTERVISTË ME SRETEN GJUROVIQIN

Beograd | Data: 4 korrik, 2017

Kohëzgjatja: 136 minuta

Të pranishëm:

1. Sreten Gjuroviq (I intervistuari)
2. Marijana Toma (Intervistuesja)
3. Boris Shebez (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Marijana Toma: Po fillojmë intervistën. Sot është 4 korrik, 2017. A mund të prezantoheni, të ma tregoni emrin tuaj, ku jeni lindur?

Sreten Gjuroviq: Mund të prezantohem. Unë jam Gjuroviq Streten, i lindur në vitin '54, në fshatin Sllatinë, atëherë komuna e Prishtinës, tash është në komunën e Fushë Kosovës.

Marijana Toma: Ky është një fshat pranë?

Sreten Gjuroviq: Pranë aeroportit, aeroportit të Prishtinës.

Marijana Toma: Më thuani, a mund të më tregoni diçka rreth fëmijërisë, familjes tuaj, prej nga është familja?

Sreten Gjuroviq: Paj, familja. Baba im ka ardhur me dy vjet, më 1914, janë bartur nga Toplica. Ndërsa nana është... ata kanë ardhur më 1918, jo '18, por '22, në fshatin Gracko e Vjetër. Nana është Drashkoviq, ndërsa baba Gjuroviq.

Marijana Toma: Prej nga kanë ardhur ata të nanës?

Sreten Gjuroviq: Njëjtë nga Mali i Zi. Njëjtë. Baballarët e kanë prejardhjen nga Mali i Zi, mirëpo kanë qenë këtu në kufi me Toplicën.

Marijana Toma: Me çfarë janë marrë prindërit?

Sreten Gjuroviq: Paj, baba ka qenë nëpunës, ka punuar në komunë. Ai ka qenë mjaft aktiv si një kuadër i pasluftës. Ndërsa nana ka qenë shtëpiake. Kemi qenë nëntë, por tre kanë vdekur gjatë kohës së luftës dhe kemi mbetur gjashtë, dhe tash kur kemi ikur si refugjatë, na ka vdekur, më ka vdekur vëllau dhe dy motrat. Tash kemi mbetur edhe tre.

Marijana Toma: Më tregoni diçka rreth rritjes tuaj? Kjo ka qenë kur?

Sreten Gjuroviq: Ha, një fëmijëri e lumtur, një fëmijëri e bukur. Kjo është diçka që njeriu nuk mund ta përshkruaj, kjo duhet të përjetohet, mirëpo ka qenë mjaft bukur. Pasi që jemi rritur në një mjedis normal ku të gjithë e kemi njohur njëri-tjetrin, ku jemi respektuar, kemi folur gjuhët më të përafërta.

Pak shqip, pak serbisht, ka qenë bukur, me të vërtetë ka qenë bukur. Kemi pasur fqinjë të mirë. Jemi rritur, po ua them, ashtu në atë mjedis të madh me shumë fëmijë dhe ka qenë tepër mirë. Po mendoj, të gjitha familjet serbe dhe *šiptarske*¹ kanë pasur shumë fëmijë dhe për të gjithë ka qenë mirë me aq sa kemi pasur. Ka qenë një jetë thjeshtë, mirëpo e shëndoshë, e bukur, e lumtur. Çdo mëngjes zgjoheshim shumë të lumtur, të kënaqur që do ta shohim njëri-tjetrin dhe që do të shoqërohemi.

Marijana Toma: Ky ka qenë një fshat i përzier aty ku keni jetuar?

Sreten Gjuroviq: Paj, më shumë ka pasur shqiptarë se sa serb, mirëpo ka pasur mjaft serb. Kanë qenë diku 20 përqind, 30 përqind serb.

Marijana Toma: Dhe më thatë që ju jeni '54-sh? Ju jeni?

Sreten Gjuroviq: Ashtu është.

Marijana Toma: Ju pra keni shkuar në shkollë në vitin '61?

Sreten Gjuroviq: Ashtu është. Unë kam shkuar në shkollë në fshatin Sllatinë e Madhe. Ka qenë shkollë katër vjeçare, ksi deri në klasën e katërt, e përzier, me paralele të përziera, i pari, i dyti, i treti, i katërti. Pas kësaj kemi shkuar nga Sllatina në Fushë Kosovë, të pestën, gjashtën, shtatën dhe tetën klasë. Dhe atëherë udhëtonim. Një kohë kemi udhëtuar në këmbë, më vonë kur filloi autobusi për Sllatinë dhe Vrellë, atëherë shkoni me autobus. Mirëpo kështu, në mëngjes të gjithë kemi udhëtuar me atë autobus.

Marijana Toma: Pra ju në të mesmen keni shkuar në Prishtinë?

Sreten Gjuroviq: Në Prishtinë.

Marijana Toma: Cilën shkollë të mesme e keni përfunduar?

Sreten Gjuroviq: Ekonomikun.

Marijana Toma: Dhe pas kësaj keni planifikuar të punoni?

Sreten Gjuroviq: Paj...

Marijana Toma: Që edhe më tutje të jetoni në fshat?

Sreten Gjuroviq: Ka pasur shumë plane, mirëpo unë shumë shpejt u punësova. Shkova në ushtri dhe kur jam kthyer shumë shpejt u punësova dhe fillova të punojë në shpedicion, shpedicion ndërkombëtar, "Jugoshped"². Pastaj, në vitin '77 së bashku me drejtorin Kisiq Nedelko themelua "Kosovoshped"³, kemi qenë firmë shumë e suksesshme. Dhe unë në të '90-tat e braktisa dhe e themelova firmën time, që njëjtë merrej me shpedicion. I kam pasur 40 të punësuar. Prej tyre gjysma kanë qenë shqipëtar dhe kjo në kohën më të vështirë përgjatë '91-'92.

¹ Term dergoativ ndaj shqiptarëve e menduar të krijojë diferencë në mes shqiptarëve të Kosovës dhe Shqipërisë.

² Kompani e shpedicionit.

³ Njëjtë.

Ata të cilët kanë punuar për mua, atyre, e di, ka pasur edhe këtu fjalë, “Po punon për serbin, knej e anej...” Unë u them, “Dëgjo, a po jetojnë mirë fëmijët e tu? Puno tek romët, kinezët, nëse fëmijët të jetojnë mirë mos e lë vetën në rrugë”. Ata e kuptuan që jeta vazhdon, që kjo është ekzistenca dhe kurrënjëfarë problemi nuk kanë pasur. Unë dhe ata e kemi pasur mirë. Kuptoheshim mirë me njëri-tjetrin. Çfarë t’u them, kur njeriu ka kënaqësi në shtëpinë e vet shumë gjëra më mirë përballohen. Dhe kështu jeta ka vazhduar deri më ‘99. Më ‘99, më pas erdhi ajo që nuk bën dhe shkuam të gjithë ku mundëm.

Marijana Toma: Më thuani ju jeni martuar në cilin vit?

Sreten Gjurovic: Unë jam martuar në vitin ‘82.

Marijana Toma: Dhe kjo si ishte, ku?

Sreten Gjurovic: Në fshatin tim. Gruaja ka qenë në fakultetin e mjekësisë, viti i tretë katërt i stomatologjisë dhe më pas erdhi në fshat dhe aty u lind djali i madh Lluka. Baba më ka vdekur më ‘82, ndërsa Lluka është... baba njëjtë është quajtur Lluka edhe djali Lluka, djali u lind në vitin ‘83 në mujin prill. Pra, pa u mbush mirë një vjet nga vdekja e babës. Ndërsa baba për ko incidencë me 4 maj, kur Tito është varrosur edhe ai po të njëjtën ditë. Ishte ajo, gati një mijë njerëz në varrim të babës tim të ndjerë dhe ndër të tjerë ka pasur edhe shumë shqipëtar, poashtu edhe hoxha, një këtu nga fshati ynë.

Dhe erdhën kusherinjtë, përndryshe nëna, ata të anës së saj kanë ardhë nga Vërbasi dhe ata erdhën këtu, në këtë ditë kishte pasur demonstrata të mëdha me 4 maj, ‘82, ka pasur demonstrata të mëdha në Prishtinë. Edhe ata erdhën me menxi me shumë probleme deri në fshat, deri tek ne, kur e kanë parë sa njeriu kishte ardhur, sa populli, fqinjët tonë thanë, “Çka është kjo?”

Dhe tash këta që kishin ardhur nga ana e nanës nuk e kuptonin, nuk mund ta kuptonin që shqiptarët kishin ardhur në varrimin e babës tim. Dhe një Miftari i cili ka punuar në komunë me babën tim të ndjerë po e mbanë fjalimin dhe po qanë. Dhe kjo bash po u dukej e pakjartë njerëzve. Mirëpo shihej që ky mjedis në të cilin kemi jetuar, këta njerëz, nuk janë marrë me gjëra politike. Ata punonin në ndonjë fshat, në fushë, në Kombinat në Obiliq, këtu ishte Bellaqevci. Shumë njerëz kanë qenë këtu të frikësuar dhe filloi të tensionohej situata.

Po ndodh, po ndodh, dhe në ‘90-tat e disa vite, atëherë djalli i mori gjërat në duart e veta dhe ne filluam të urrejmë njëri tjetrin pa asnjë arsye. Unë nuk e urrej askend në botë, mirëpo i kanë pasur ato ide disa, mirëpo ato kanë qenë budallaki. E tëra ka qenë budallaki sepse njerëzit duhet të jetojnë me njëri tjetrin, që ta ndihmojnë, të shihen, të punojnë, të përfitojnë, të bëjnë ekonomi, që gjithçka që bartë jeta duhet të të të... Unë them, e kemi një proverbë nga fshati ynë andej, edhe shtazët ledhatohen me secilën, edhe ne duhet t’i ndihmojmë njëri tjetrit, dhe të takohemi ashtu siç ia bëjmë këtu nëpër Beograd dhe kështu.

Marijana Toma: Realisht deshta me ju pyet, pasi që nuk e kam pasur rastin të flas me shumë njerëz të moshës suaj dhe që u kujtohen gjërat aq mirë. Këto të ‘80-tat, pra, kur flisni për varrimin e babës suaj, kjo flet për një komunitet?

Sreten Gurovic: Po.

Marijana Toma: Në anën tjetër e dijmë për tensionet të cilat kanë ekzistuar. Si u është dukur kjo, meqenëse keni qenë mjaft aktiv, që keni punuar?

Sreten Gjuroviq: Si është dukur? Do t'u tregojë se si është dukur kjo. Është dukur mjaft çuditshëm dhe shumë e paspjegueshme. Si një grup njerzish e gjejnë një arsye në diçka që ndodh që nuk ekziston, hajt po themi që po ekzistojka. Ani çka, a duhet të dalim në rrugë dhe të themi që ky është problem? Jo, kemi mundur të ulemi në tavolinë siç ulen sot. Pas çdo mosmarrveshje vijnë dhe merren vesh, mirëpo unë mendoj që është mirë të merremi vesh të flasim para mosmarrveshjeve. Dhe me dialog, me një dialog më të gjatë do të ishte më mirë. Mirëpo neve, jo neve, mirëpo ka qenë qëllim i dikujt që të krijojë këtë mosmarrveshje që për askend s'ka qenë e dobishme; që të dalim në rrugë dhe të shkatërrojmë dhe me këtë të shprehim pakënaqësinë. Nuk është shprehje e pakënaqësisë nëse shkatërroj diçka.

Marijana Toma: Çka ka qenë kërkesa atëherë, a ishte ajo?

Sreten Gjuroviq: Kërkesa atëherë ka qenë që ushqimi i studentëve nuk ishte në rregull⁴, kjo, ajo, dhe disa gjëra pa arsye që nuk kanë qenë të vërteta. Shumë më mirë ka qenë për ata studentë të cilët kanë jetuar në konvikte se sa në shtëpitë e tyre. Prapë se prapë në konvikt kanë jetuar falas dhe i ka pasur të gjitha.

Çfarë tash kërkon? Nuk e di, unë nuk e kuptoj. Mirëpo mendoj që kjo është ashtu, sepse më pas kam kaluar me vendbanim mëtanë rrugës nga konvikti dhe i kam shikuar. Dhe më pas nga të '80-tat kanë filluar më shpesh që të ndodhin këto demonstrata dhe këto t'inicijojë dikush, ai dikushi, nuk e di kush është ai. Këta që po e kërkojnë demokracinë. Nëse kam të drejtë apo jo nuk e di, mirëpo e shoh që nuk po ecën mirë. Nuk ecën mirë pasi që e shtyjme dikë që në rrugë të kërkojë drejtësi. Kjo është budallakia më e madhe për mua. Shkon aty tek institucionet ku janë, të cilat janë, dhe e bën atë kërkesë, që të merren vesh dhe jo tash të del në rrugë dhe të fillojë të shkatërroj dhe të thotë, "Mua nuk po më pëlqeni që keni flokë të bardha". Këto janë budallaki, mirëpo kjo po ka efekt.

Marijana Toma: Më thuani, tash kjo ka të bëjë me jetën. Ju e keni një djalë apo sa fëmijë?

Sreten Gjuroviq: Jo, unë i kam dy djem Llukën edhe Llazarin, ata janë lindur aty. Ka qenë fatkeqe dhe më është dashur t'i marrë nga Prishtina të lindin në Krushevc. Këto tensione, këto, ato, fëmijët këtu, këto budallaki, mirëpo për shkak të vetëpërmbytjes, kam thënë nuk do mundohna ta bind askë, hajde, do të shkojmë në Krushevc dhe ata lindën atje, por u kthyen dhe jetuam në Prishtinë. Kemi jetuar në Bregun e Diellit dhe tani fëmijët shkuan aty në shkollë. Unë kam punuar, po tregoj që kam qenë i suksesshëm.

Kompania ime ka qenë e 127-ta në ish-Jugosllavi nga 66.000 ndërmarrje. Kemi punuar. Unë nuk kam qenë i njëanshëm. Kur vijnë palët tek unë nuk lejoj të më përfshijnë nëpër punë, mirëpo e ftoj brenda, merremi vesh dhe këtë e përfundoj përgjatë bisedës. Deri sa, deri sa nuk e pinë kafën ne ia përfundojmë punën dhe më pas kjo ishte reklama ime më e madhe, vetë palët. Unë kam, për shembull nga njëqind përqind të palëve, 80 përqind nga palët kanë qenë shqipëtar te unë.

Marijana Toma: Kanë përdorur shërbimet e kompanisë tuaj?

⁴ Protestat e studentëve të vitit 1981, fillimisht ka nisur si pakënaqësi ndaj ushqimit në menza.

Sreten Gjuroviq: Shërbimet e mia të shpedicionit. Dhe kam pasur miq shqipëtar që kanë pasur kompani të shpedicionit dhe më pyetnin, “Çfarë po u bën [që po vijnë te ti]?” Unë asgjë nuk po u bëj, po ua them të vërtetën. E vërteta është e dhimbshme por e shëndetshme.

Marijana Toma: Përse e keni braktisur punën e shtetit, kjo është?

Sreten Gjuroviq: Po të ju tregojë, unë kam... Ka filluar kjo kohë, si quhet, kur kanë filluar të hapen kompani... Dhe unë gjithnjë kam qenë i paretshëm dhe kam dashur të shoh nëse mundem edhe unë ta gjejë vetën në këtë punë dhe shumë kam qenë i suksesshëm. Sepse te unë nuk kishte punë të cilat nuk mund të kryheshin. Duhet gjithçka të përfundohet, mirëpo edhe duhesh më shumë mund të investosh që kjo të realizohet. Dhe kur e definon mirë një linjë, më pas kjo ecën lehtë. Njerëzit mendojnë që është lehtë. Nuk është lehtë, kjo është shumë vështirë, mirëpo kur ke ekip të mirë, një ekip që të dëgjon, kur njerëzit të dëgjojnë pastaj gjërat shkojnë më lehtë.

Marijana Toma: Dhe si është për ju? Më treguat që kompania juaj ka qenë shumë e suksesshme. Ku keni punuar, nëpër tërë Jugosllavinë, në Kosovë, apo?

Sreten Gjuroviq: Unë atëherë kam punuar më së shumti në Kosovë, më pas aty te Leskovci, sepse nuk kishim në atë kohë, kso... Më pas filluan këto trazirat dhe të gjitha këto që nuk bëjnë dhe më pas nuk kishte, si t’ua them, momente të mira për t’u zgjeruar në tërë Jugosllavinë. E kemi pasur si qëllim, mirëpo qëllimet tona kanë qenë të vogla.

Marijana Toma: Në atë kohë a keni folur, po mendoj, a keni pasur miqësi me shqipëtar, a keni folur kur kanë filluar këto tensionet atëherë kah mesi i ‘80-tave?

Sreten Gjuroviq: Me njerëzit e thjeshtë shumë lehtë kuptohesh, mirëpo njerëzit e thjeshtë nuk pyeten. Unë do të thotë, populli është të mos i thërras, populli është si një pako. Sepse kombësia ime... të mos shprehem, sepse populli çfarë mund të bëjnë ata? Kur të vijnë rrymat, duhet të shkosh me popullin, ku do shkosh, çfarë do të bësh? Ne folëm shumë për atë se çfarë duhet të bëjmë, kështu që ishte në televizion dhe kjo ishte çdokund.

Të vështira kanë qenë këto kohëra, po mendoj të mbrapshta, nuk e di as vetë. Tash flas me miqtë dhe të afërmit e mi, dhe them sa bukur kemi jetuar. Po, mirë kemi jetuar, ne të cilët kemi lejuar të na udhëheqin që nuk ka pasur asgjë të mirë në mendje, vetëm ka krijuar tensione, dhe ne kemi qenë ata të cilët i kemi mbështetur ato tensione. Kjo është zhvilluar shumë, shumë keq për të gjithë, jo vetëm për ne. Këtu nuk po i ndaj as serbët as shqipëtarët, mirëpo kjo ka qenë shumë vështirë.

Duhet njeriu të imagjinojë që jeton në një rreth ku këto... kur unë flas nëpër Beograd dhe Serbi që atje edhe qentë tonë janë respektuar, qentë, që as nuk kanë dashur të lehin në njëri-tjetrin. Dhe këtë harmoni e shkatërron, pse duhet të flas unë tutje. Do të thotë shtazët janë respektuar, paramendoje ne njerëzit. Sepse motra ime e re, më reja e cila ka vdekur, ajo ka punuar si motër medicinale. Ajo vishej, ngiste veturën, vishej në rroba tradicionale shqipëtare dhe të gjithë pyesnin, “E kujt është kjo?” Fqiu ynë i parë është axha Fejza, dhe ajo thotë, “E axhës Fejzë jom”.

Marijana Toma: Kjo, kur flisni për këto tensionet, sa ka qenë vështirë të bësh jetë normale, dhe prapë t’i keni këto?

Sreten Gjuroviq: Të ju tregoj diçka, vetëm një gjë të ju tregoj. Është shumë vështirë. Me njerëzit normal, shumë normal flet, mirëpo vjen dikush që i pengon, ju them, kujt i pengon ai që vjen me papuqe? Eh pra këto janë ato gjëra të cilat nuk di t'i spjegoj. Sepse kur njeriu dëshiron, për mosmarrëvshje nevojiten dy palë. Unë them, "Më lë rehat njeri, nuk kam kohë për këtë". Dhe kështu.

Nuk kam dashur të lëshohem në ndonjë, sepse e di që kjo, që nuk është mirë sepse në këtë nuk mund ta vëjmë në binar, në njerëzit e thjeshtë. Çfarë mund të përmirësojë unë, të them ky ka të drejtë ky jo? Kjo ka qenë e udhëhequr nga politika në një nivel më të lartë se sa që në njerëzit e thjeshtë, vdektarët do të mund të zgjedhim. Dhe kështu kjo, çka po di, kemi folur, mirëpo nuk ka pasur efekt zëri ynë. Dhe ka qenë më lehtë të mos flasim për këtë, por më mirë të flasim për gjëra më të lehta të përditshmërisë që t'i ndihmojmë njëri-tjetrit për gjërat që mundemi, dhe kështu.

Marijana Toma: Dhe kur e tëra filloi, ju e keni themeluar kompaninë tuaj në të '90-tat, apo?

Sreten Gjuroviq: Ashtu është.

Marijana Toma: Dhe si është kjo, prapë se prapë kishin filluar [kohëra të këqija]? Kjo ishte ende ajo periudha kur në Jugosllavi njerëzit kishin jetuar pak a shumë mirë dhe?

Sreten Gjuroviq: Mirë kemi jetuar. Unë kam jetuar, po mendoj unë kurrë nuk e kisha ndryshuar atë jetën tonë "poshtë"⁵ me asnjë vend tjetër në glob. Do të thotë kemi pasur harmoni, ka qenë mirë, jemi njohur të gjithë, përfundohej ajo, në kohë përfundoheshin punët. E thërras unë Fehmiun, "I dashur", po nuk ka lidhje kë e thërras, "ka me ardhë njeni me kry një punë atje 'poshtë'". Thotë, "Le të vije krejt ia kryjmë. Derisa ai vjen kryhet".

Këto janë ato lehtësirat të cilat ne i kemi pasur pasi që e njihnim njëri-tjetrin. Po mendoj, nuk ka pasur ndonjë, edhe kjo ka qenë me këdo në komunë, spital, në fakultet. Dhe mua sot më thërrasin, shpesh më thërrasin, më pyesin, "A e njeh ndonjëri atje?" Për ta regjistruar vajzën apo djalin në fakultet.

Marijana Toma: Dhe kjo është, prapë po i kthehem kësaj. Ju keni punuar në Kosovë dhe në jug të Serbisë?

Sreten Gjuroviq: Paj mjaftueshëm, edhe pse kam pasur palë nga Serbia qendrore, nga Beogradi, unë kam pasur një numër të madh të palëve. Do të thotë nuk ka pasur kurrëfarë problemi deri '98-tën, '99-tën, pra kur këto problemet, kur kanë filluar krizmat.

Marijana Toma: Si ka qenë në atë periudhë? Në këtë periudhë kur ndodhin tensionet e '90-tave, në këtë kohë kanë ndodh edhe ato me punësimin dhe shkollimin?

Sreten Gjuroviq: Po, përjashtimet. Të iu tregojë diçka, është budallaki të vijë unë deri në përfundime kur nuk kam qenë i përfshirë në këtë. Tash, dikush e ka braktisur, dikush është larguar, dikush kështu, dikush ashtu, mirëpo ka filluar kjo të bëhej në mënyrë të orkestruar. E dini si, dhe më pas këtë e kanë larguar, ky tjetri e ka braktisur dhe më pas i është referuar Kushtetutës së '74-tës. Dhe nuk e di, këso gjërash.

⁵ Poshtë, është formë derogative që i referohet Kosovës, përfytyrim gjeografik që e paramendon Kosovë poshtë nga Beogradi dhe Beogradin në qendër.

Unë kurrë nuk kam qenë i përfshirë në asnjë grup politik që të bëj diçka. Kurrë nuk kam, jo pse nuk kam dashur, por nëse e thua të vërtetën nuk kanë qenë të mira për asnjë palë. Ky është problemi dhe unë e kuptoni, gjithnjë e kam shikuar, jam munduar të kyçem në punë dhe jo në përralla të thata, sepse demagogjia është një gjë e rëndë. Unë në këtë nuk merrem vesh, por kam ditur mirë të punoj dhe këtu kam qenë mjaft i suksessëm. Ky ishte problemi që unë nuk kam mundur të them që kjo është e zezë, nëse për mua ka qenë e zezë nuk mund të jetë e bardhë sepse të vërtetën duhesh ta shikosh në sy.

Poqëse të gjithë kishin thënë të vërtetën deri te kjo nuk kishte ardhur, mirëpo kemi gënjyer edhe hajde se ma bukur. Çka ka me qenë ma bukur? Do të jetë më bukur vetëm nëse punon. Përrallat e thata kurrë askujt asgjë nuk i kanë sjellë, dhe askujt nuk i kanë dhuru asgjë. Këtë dhuratë që ua kam dhënë juve, unë pres nga ju të ma ktheni me diçka. Tash a do të ma ktheni me të njejtën masë apo më të madhe, ai i madhi kërkon masë më të madhe, një shërbim më të madh nga ju. Këto janë problemet.

Marijana Toma: Na tregoni si është dukur jeta juaj atëherë, a ka pasur probleme, tensione? Ju keni jetuar në Breg të Diellit, kjo është një ndër lagjet më të mira në Prishtinë?

Sreten Gjuroviq: Ashtu është. T'iu tregoj nuk ka pasur tensione deri sa nuk ka filluar '98-ta, '99-ta, unë nuk kam pasur, nuk i kam ndier ato. Ndoshta unë kam qenë i zënë me punë, as ata të mijtë nuk kanë pasur probleme. Mirëpo ka filluar në '98, ka filluar të ketë ndasi, të ketë krisma, orët policore, kjo, ajo, dhe filloi të ishte më e pasigurtë. Dhe më pas njerëzit filluan të shkojnë më herët në shtëpi.

Marijana Toma: Si duket kjo?

Sreten Gjuroviq: Po kjo ishte e tmerrshme. Si duket kjo? Shumë e tmerrshme. Deri dje ke mundur të shkosh të përqafohesh, puthesh, të punosh. Unë flas shumë mirë shqip. Nuk ka shanca teorike që dikush të vërej që unë, nga e folmja, jam serb. Gjë që për mua ka qenë kënaqësi të flas, të mund të ndihmoj. Pala tjetër ndoshta nuk ka ditur mirë, mirëpo kur e ka vërejtur që unë flas mirë atëherë janë shlyrur dhe shumë më thjeshtë kryheshin punët.

Unë, si të ju them, unë si unë, për mua nuk ka përfaqësuar problem të madh, mirëpo shumicës i ka shkaktuar probleme të mëdha, probleme të tmerrshme, sidomos kur filluan dhunimet, filluan rrahjet, filluan disa gjëra të cilat nuk janë të bukura. Dhe më pas njerëzit, ju ndodh juve dhe më pas e tërë ajo lagje thotë po pse unë të lejojë të më ndodh diçka ashtu. Dhe më pas njerëzit u tërhoqën në guacat e tyre dhe shujtën, shikonin se çfarë do të ndodh, çdo ditë vështirë e më vështirë, fuqishëm e më fuqishëm filloi presioni mbi ata njerëz që të bëjnë krime, atë e këtë.

Më pas kishte tregime të ndryshme, ai e ka vrarë këtë, ky dhe ai, kjo ka ndodhur mes tyre, mandej kjo kalonte në eufori dhe krijoheshin probleme të mëdha ku njerëzit duhej të pritnin mëngjesin që të vendosnin a të shkojnë apo të qëndrojnë. Unë kam qëndruar deri më 12 qershor apo 18 qershor, '99. Çka më pas... ka qenë moment i vështirë, i vështirë për të vendosur a të shkoj edhe unë.

Kur dola nga Prishtina kam pasur një Golf dhe e vendosa një patikë angleze, i kam pasur një palë, patika të Zastavës, kinse Zastavë angleze, dhe i hoqa tabelat dhe u nisa kah kufini, nëse më ndalin do t'u them që po vozis gazetarët. Edhe kompjuterin e kisha në veturë dhe askush nuk më ndali dhe kalova, mirëpo ka qenë mjaft tensionuese. Tensionuese ka qenë diçka dhe kurrë nuk kisha dashur, vështirë më vie edhe kur i kujtoj ato ditë, e kupton? Ka qenë tmerr, tmerr.

Marijana Toma: Ju keni qenë gjatë gjithë kohës '98, '99 në Kosovë?

Sreten Gjurovic: Unë kam qenë deri në muajin qershor '99. Në vitin '99, 18 qeshor unë kam ardhur këtu. Gruaja dhe fëmijët kanë ardhur më 24 mars, dhe unë e kam blerë këtë shtëpinë këtu dhe kishim ardhur. Dhe nëna më ka vdekur, po këtë e kisha harruar. Ditën e dytë të bombardimeve mu më vdes nëna. Ka qenë tmerrsisht keq, kjo ishte, nuk e di si ta përshkruaj. Po mendoj, nuk kisha dashur askush ta përjetoj këtë moment në jetë, kur prindërit i vdesin dhe nuk dijnë se si t'i varrosin. Nuk mund të çelësh një varr, jo prej fqinjëve të mi në fshat, ata do të më ndihmon me siguri.

Ndërkohë që ndodhnin bombardimet, më pas njerëzit në njëfarë, nuk e di si t'ua tregoj këtë, në njëfarë frike. Më pas tregoheshin tregime, nëse shkoni aty në fshat do të shtiejnë në ju. Mirëpo, çka? Unë kisha vendosur ta varros nënën pranë babës.

Marijana Toma: Në varreza?

Sreten Gjurovic: Në varreza në Sllatinë. Kam mundur edhe në Prishtinë ta varrosi, mirëpo thashë, jo do ta varrosi në fshat. Ajo e shkreta prej frikës ka vdek. Ditën e dytë i hypi tensioni, sepse ishim shumë fëmijë aty dhe disa tjerë aty, disa atje, dhe asaj i hypi tensioni, deri sa arritëm në spital ajo vdiq. Dhe më pas e varrosëm në fshat. Dhe këto janë gjëra të tmerrshme. Pas kësaj unë çdo vit shkoj në, në, në, si quhet në përvjetorin e saj.

Unë kam shkuar në çdo përvjetor të nënës atje, që nga viti i parë. Një vit u pata bllokuar atje në fshat, kishte borë. Dhe kur këta fqinjët më shohin edhe ata sikur panë... Së pari unë jam mjaft i afërt me ta dhe iu thashë fjalë të pista. Çka ata... ata erdhën i tërë fshati për të ma nxerrë veturën sepse ishte borë e madhe. Një vit, në përvjetorin e shtatë të nënës shkuam me njërin nga shokët e mi, Ramadanin nga Vuçitërrna, ata janë tetëmbëdhjetë fëmijë. Ka një këngë Bora Çorba ka kënduar një këngë për ta, "Serbët dhe kroatët na kërcënojnë, Krasniqët presin të tetëmbëdhjetin fëmijë". Ata janë njëmbëdhjetë vëllezër. Dhe ky Ramadani që është një shahist i madh erdhi me mua dhe i shkuam nënës në varr që unë t'ia ndez një qiri.

Një gjë e çuditshme ndodhi atëherë. Aty ku janë varrezat tona, dhe kjo nuk më pëlqen çfarë kanë bërë, kanë bërë një gjë të keqe, i kanë dëmtuar varrezat. Kujt i pengojnë njerëzit e vdekur? Kanë larguar varrezat. Tash kjo varrezë është në shkurre. Këtë nuk e arsyetoj, këtë nuk e arsyetoj, nuk bën. Nëse nuk mundesh të merresh vesh me njëriun, mos ia fut kot. Sidomos kjo hapësirë e shejtë, e kupton. Këtu janë këta njerëz të vdekur. Çfarë tash atyre duhesh t'ua bësh këtë? Kjo nuk më pëlqen.

Themi kjo varreza jonë atje është përplot mbeturina, gjuajnë mbeturina, e shkatërruar, katastrofë. Ndoshta dikuj do t'i kujtohet se kjo duhet mirëmbajtur, që duhet të jetë bukur, që t'ia dëshmojë botës që ja pra ne kujdesemi për të vdekurit, po mendoj, nuk po flasim për të gjallët. Dhe them në këtë përvjetor me Ramadanin, unë hyra në varreza dhe e shkatërruar ishte, të shkatërruara pllakat e varreve. Tash njeriu ishte ndalur pak më larg nga unë dhe unë po e ndezi një qiri, e dini, dhe qiriu po ndizej. Ia ndeza babës, nënës një qiri dhe përnjëheri po ndalen qirinjtë.

Unë po i them Ramadanit, "U ndalën ma jep shkrepzën", sepse unë nuk pij duhan. Dhe vie deri tek unë dhe kur kthehem qirinjtë ishin të ndezur. Unë po mendoj me siguri po halucinoj, ndodh që më është dukur, mirëpo kur e tëra përfundoi unë u kryqova dhe u nisa kah shtëpia. Ka një dru dardhe pas nesh, këtu ku janë varrezat e prindërve, dhe kur ka filluar ajo dardha, vetëm një dardhë të bëj zhurmë të lëkundet e tëra.

Marijana Toma: Vetëvetiu?

Sreten Gjuroviq: Vetëvetiu. Dhe ky Ramadani po më pyet, ndërsa ishte zbehur si letër, “Hej bre”, po më pyet, “çka është bre kjo?” Thashë, “Ramadan nuk e di, mirëpo diçka ekziston, një fuqi ekziston.” Andaj, dhe nuk më vie keq, më vie keq që dikush që nuk ka ide për jetë normale na ka detyruar edhe neve të bëhemi si ai. Në vend se të respektohem, të duhem, të...

Unë i kam shkuar këtij Ramadanit në ngushllime. Të gjithë e kanë ditur që unë jam serb, kur i vdiq nëna, pas këtij rasti nëna i vdiq. Të gjithë e kanë ditur, të gjithë më kanë respektuar. Këto janë, të ju tregoj diçka, në një moment të vjen mirë, në një moment të vjen pikëllim sepse nëna i ka vdekur. Unë ia shprehi ngushllimet e mia, mirëpo më vjen mirë që ata njerëz më respektojnë. Kjo prapë është diçka për t'u çmuar. Tash kur shkoj unë në fshatin tim, unë shkoj një herë në muaj, çfarë më thotë mua gruaja, “Ty të kushton më shumë se sa frizura e Cecës.”⁶ Unë shkoj çdo muaj t'i prej flokët dhe para se të gjithash shkoj me veturë, dhe ulemi të pijmë dhe shkojnë 200, 300 Euro.

Marijana Toma: Shkoni në Kosovë te frizeri?

Sreten Gjuroviq: Po, te frizeri. Shkoj atje në fshat. Në fshatin tim ka tetë hotele. Më së vështiri më vjen kur e shoh, shumë vështirë është, shikoni gjithnjë e më pak shfrytëzohet ajo botë e të rinjve, përdërisa ata nuk kanë prej çfarë të jetojnë. Vuajtje, vuajtje pesë euro, shtatë euro, nuk ka punë, nuk ka punë. Gjëja më e keqe është që nuk ka punë, ndërsa kanë premtuar kamiona, miliona, asgjë, shumë keq. Çfarë ka bërë bashkësia ndërkombëtare, çka? Asnjë fabrikë nuk e ka krijuar atje “poshtë”. E kanë shitur Elektroekonominë për ta bërë rrugën aty poshtë dhe dhjetëra njerëz jetojnë aty, dhjetë familje. E këto të tjerat janë katastrofë, nuk e di si do të përfundoj e tëra, mirëpo nuk është mirë, nuk është mirë.

Pjesa e Dytë

Marijana Toma: Unë do të doja të kthehem, ju përmendet që nëna juaj ka vdekur në ditën e dytë të bombardimeve dhe nuk e përfundat si e varrosët?

Sreten Gjuroviq: Mezi e kemi varrosur, deri sa kemi gjetur njerëz për t'ia hapur varrin. Bombardimet ishin, afër këtu e kishim aeroportin, dy kilometra larg. Vija ajrore nuk është asnjë kilometër. Dhe çdo minut kanë rënë bombat, çdo minut. Dhe ajo e shkreta atë natën e parë kur binin bombat që vinin nga drejtimi i Shkupit dhe të dukej që vinin në drejtim tëndin dhe kjo krijonte nervozë dhe frikë. Prej frikës ka vdekur gruaja. Ajo më tha, “Unë e kam kaluar një luftë”, dhe ajo më ka detyruar ta blejë këtë shtëpi. Unë e kam blerë këtë shtëpi për pesë minuta.

Marijana Toma: E keni blerë para luftës?

Sreten Gjuroviq: Jo, unë e kam blerë këtë shtëpi në shkurt, '99 dhe ajo më ka detyruar një muaj para.

⁶ E ka fjalën për Svetlana Ražnatović Ceca, një folk këngëtare e popullarizuar në Serbi, poashtu e veja e Arkanit, i njohur për krime lufte në ish-Jugosllavi.

Marijana Toma: Si ju ka detyruar, çfarë ju tha?

Sreten Gjurovic: Tha... unë nuk e kam pasur mendjen të zhvendosem, po çfare. As në çmendi nuk do të më kishte shkuar mendja të zhvendosem, as mua, as gruas, as fëmijëve, askujt. Dhe ajo më thotë, “Djali jem...” Askush prej nesh nuk ka blerë, as vëllezërit e mi, motrat, nuk kanë blerë asgjë. Madje, unë ende e kam motrën time në Graçanicë, ajo jeton atje. Më thotë, “Blej diçka që të mos maltretohemi si luftën e kaluar. Unë kam jetuar shumë gjatë në vagone, nuk kemi pasur ku të strehohemi. Bleje një shtëpi, diku të strehohemi nëse ndodh diçka”. I them, “Hajt bre, nanë! Mos mendo vetëm në më të keqën”. “Djali jem, të lutem. Unë e di, unë kam kaluar në të gjitha ato, i kam parë”.

Dhe çfarë të bëj unë, e ndëgjova dhe e bleva këtë shtëpi këtu për dy minuta. Sado që i ka kërkuar, aq ia kam dhënë. Nuk kam pasur kohë, filluan ato të shtënat dhe si binte terri askush nuk ishte në rrugë. E vranë Donkan njëfarë shoferi i cili voziste për “Turist Kosovën” si e kanë vërejtur që... sepse e kanë ditur kush ka qenë cili nëpër male pas orës 20:00, që askush nuk vozitë, përveç nëse është serb, sepse shqiptarët nuk shkonin. Dhe më pas e kam blerë këtë shtëpi këtu dhe kështu erdhëm këtu. Ata erdhën me 24 [mars], në ditën e bombardimeve, ndërsa unë erdha me 18 qershor. Dhe nëna...

Marijana Toma: Dhe ju keni qëndruar vetë atje?

Sreten Gjurovic: Vetëm, vetëm.

Marijana Toma: A keni qenë në kontakt me ndonjëri? Kompania nuk ka punuar?

Sreten Gjurovic: Po, ka punuar, deri 15-20 ditë para qershorit, kompania ka punuar, kemi punuar. Ka shkuar malli, kupton, megjithatë...

Marijana Toma: Si ka qenë me jetu në Prishtinë atëherë, kjo është...?

Sreten Gjurovic: Shumë keq.

Marijana Toma: Prishtina ka qenë e bombarduar aq shumë...?

Sreten Gjurovic: Shumë keq ka qenë të ju tregoj. Kur kanë filluar të shkojnë shqiptarët mua më ka ardhur shumë rëndë. Vjen fqiu dhe më pyet mua aty nga hyrja, “Hajde vozitëm deri te Zamoka”. I them unë, “Unë nuk muj me të vozitë askund”. “Pse?” “Po, më vrapnë edhe mu edhe ty. Çka e di unë kush është në rrugë? Rri këtu. Nëse të duhet ushqim, kjo, ajo, krejt janë këtu. Unë mundem me t’furnizu me ushqim te hyrja, madje këtë mundem me veturë”.

Më ka ardhur shumë keq pasi që nuk kam mundur as t’i ndihmoj as ta vozisë deri aty, kryesisht pse u jemi ekspozuar edhe unë edhe ai problemeve. Nëse na ndal dikush rrugës, “Ja ky vozit për pare”, apo diçka ngjashëm. Unë u thashë të rrini këtu, ushqim, sa i përket ushqimit, me bukë ju furnizoj unë. Ka qenë vështirë, shumë vështirë.

Marijana Toma: Ndërsa jashtë në rrugë, jeta e përditshme?

Sreten Gjurovic: Nëpër rrugë ka pasur, shkonin njerëzit, shihej, që nuk ka, e dini, të ftofta, kanë qenë raporte të ftofta. Ka qenë vështirë, vështirë ka qenë.

Marijana Toma: Pra, ju kur e keni ble këtë shtëpi, e keni ble me qëllim që të zhvendoseni apo sa për ta pasur?

Sreten Gjurovic: Vetëm për ta pasur, pra. Për t’ia plotësuar këtë dëshirë nënës, mirëpo nëna ka pasur të drejtë. Poqëse nuk e kisha blerë, unë do të isha në rrugë. Po mendoj, ose në ndonjë vendbanim kolektiv. Shumë ka qenë vështirë në atë kohë, çfarëdo që do të kishit bërë atje “poshtë”. Unë kam pasur më pas probleme. Unë e kam pasur në qendër të Prishtinës një zyre. Kam pasur 200 kuadrat bash në qendër të Prishtinës, përballë [Hotel] Grandit. Edhe sot e asaj dite njeriut që ia kam dhënë, e kemi ndërruar këtë me Avallën, ai nuk mund të hyjë. Kanë ardhur disa njerëz, po mendoj këta janë bashkësia ndërkombëtare.

Marijana Toma: Si nuk mund të hyjë?

Sreten Gjurovic: Nuk mund të hyjë në hapësirën e zyrës, nuk e lejojnë këta.

Marijana Toma: Ju ia keni dhënë atë? Ai i ka dokumentet?

Sreten Gjurovic: Unë i kam dhe ai është i autorizuar. Ai i ka dokumentet, ai është i shënuar në kadastër në Prishtinë dhe nuk mund të hyjë. Unë për njëmbëdhjetë vjet kam udhëhequr betejë me bashkësinë ndërkombëtare, një drejtor që ka qenë aty, drejtori i agjencisë që kthen pronën, Skot Boven, Skot Boven. Unë i them atij, “Njeri, unë jam në një pozitë të padrejtë, të padrejtë. Unë i kam të gjitha dokumentet që kjo është e imja, që kjo është pronë e imja. Ti tash e ke lejuar njeriun i cili e ka uzurpuar të banojë aty. Unë tash duhet të dëshmojë, ndërsa ai nuk duhet për të qëndruar aty”.

Kur kam shkuar herën e parë 101 ka qenë numri i landës, 101 është numri i landës. Unë shkoj për të identifikuar hapësirën e zyrës, i them, “Kjo dera këtu është”. Dhe ai fotografon. Pas kësaj kthehem prapë dhe pas një viti ata më thonë, “A je në mend?” Pyes, “Pse bre?” “Po ti i ke treguar gabim”. “A po më merrni për budalla?” Dhe unë e shoh se ata po luajnë me mua dhe them, “Hajde pra prapë shkojmë. Kjo është dera sikurse herën e kalume.” Ai po çuditet. Këto janë lojëra pa kufi. Nuk bën kështu.

Për mua kjo është një fotografi e shëmtuar, fotografi e shëmtuar kur dikush provon të të mashtrojë. Ti je pronar legjitim i asaj hapësire, e dëshmon, dhe ai që nuk është rrin aty brenda. Po mendoj, më duket budallallëk të shkoj unë aty, me mua ishte bash ai shqiptari i cili e kishte blerë prej meje. Shkoj në komunë, kam paguar 10 000 vitin e kaluar, 10 000 Euro për një pronë të cilën nuk e përdori. Dhe shkoj në katin e katërt te drejtori i financave dhe unë ankohe me pse do të duhej të paguaja unë. Dhe unë i tregoj, gjithçka i flas në shqip dhe ai më thotë mua, “Hajt bre çka po këmbëngul aq shumë për atë serb?” I them, “A e din çfarë na kanë bërë gjatë luftës? Na kanë bërë të gjithëve”. Tash unë fillova t’i tregoj si neve na kanë bërë, nuk ta kanë bërë vetëm ty. “Mos të flasim më”. I them unë, “Fqiu im, po unë jam ai”.

Këto janë gjëra të cilat bre... Unë kam shkuar edhe në Drenas, jam vozitur me tabela të Beogradit derisa punoja për Feronikelin, më ka ndodhur që në Prizren një njeri të më kërcënohet me kështu me gisht {tregon me dorë} deri sa shkoja me veturë me tabela të Beogradit. Unë ndalem dhe i them, “Pse më kërcënohesh?” Unë i flas në shqip dhe ai më thotë, “Më fal mendova që je serb.” “Po, unë jam serb. Ani çka?” Dhe ai ikën. Këto janë gjëra të cilat...

Marijana Toma: Më thuani kur keni ardhur këtu, ju keni hapur, me çfarë jeni marrë?

Sreten Gjurovic: Jo, unë për një muaj kam...

Marijana Toma: Me çfarë jeni marrë?

Sreten Gjurovic: Njëjtë jam marrë me shpediton dhe ende ajo kompani ekziston. Mirëpo për një muaj kam qenë në njëfarë depresioni sa që në bazë nervore jam bllokuar. Më vinte mundim, s'di çka. Më thirrnin njerëzit nga lartë, aty, këtu, nuk e di. Më e keqja është kur e humb rrugën në oborrin tënd. Nuk ka, shikon në të gjitha anët nuk ka askund rrugë, vetëm sillesh në rreth si klysh i tërbuar.

Dhe më pas këtu kam filluar të punoj në këtë podrum, këtë, atë, dhe jam qetësuar dhe gjërat kanë filluar që të... E din kur të imponohet diçka që nuk të pëlqen. Sikur të ju kisha shtyrë unë juve të bëheni kirurg e juve nuk ju pëlqen.

Mua më kanë hutuar aq shumë, sa që mora një mulli e ndrrova, dhe ajo, pastaj gjithçka ndodhi, po mendoj. Nuk kisha dashur askujt t'i ndodhte, të përsëritej. Kur të imponojnë diçka padëshirë, kur të imponojnë diçka padëshirë, unë nuk kam vullnet, ta imponojnë dhe tash duhesh. Ja pra këto janë gjëra që të ndodhin pas atyre viteve të çmendura, a kupton? Tash thojnë që pronën do ta kthejnë, çfarë kthimi? Kush është kthyer, kush do të kthehet? Askush nuk është kthyer.

Vijnë dhe më thonë mua, "Hajde të kandidohesh për ministër". Njerëz, unë aty do të kem vetëm dobi personale, vetëm dobinë personale, dikush do të më fyej për këtë, dhe tani fëmijtë e mi të më thërrasin dhe prindërit e mi të vdekur të më thërrasin dhe të thonë, "Hej bre, prit po ti paske ardh vetëm për me marrë pare". Këtë kurrë s'e kam dashur, nuk ka pare për të cilat e kisha bërë këtë.

Marijana Toma: Ju kanë ofruar të aktivizoheni politikisht?

Sreten Gjurovic: Po, po.

Marijana Toma: Kur ashtu?

Sreten Gjurovic: Po menjëherë si filloi sistemi shumëpartiak atje "poshtë" dhe unë them, "Jo, nuk është kjo punë për mua". Nuk mund ta shikoj dikend dhe ta gënjej. Këto janë gjëra për të cilat duhesh të kesh lukth ta tretësh.

Marijana Toma: A mund të më flisni, të më tregoni diçka më shumë rreth jetës tuaj këtu. Pra, si keni filluar këtu dhe si e keni krijuar këtë në Avallë?

Sreten Gjurovic: Të ju tregoj, jeta ime këtu është mundim. Sa më përket mua personalisht. Për fëmijët e mi është mirë. Nëse e shikojmë kështu unë kam kaluar 80 përqind të rasteve mirë. Unë kam ble shtëpinë atje, këtë në Avallë e kam marrë atje. Unë nuk kam njerëz me të cilët kam punuar, me të cilët kam qenë i afërt për t'ia fyer nënën, atë, këtë, dhe të shkoj në gjysmë të natës te ai dhe t'i them, "Zgjohu bre!" Këtu nuk ka raporte të tilla, pasi që njerëzit janë...

A e dini si, mirë e kanë pasi që shumë nga ne jemi të ardhur. Dhe 80 përqind të njerëzve kanë humbur dhe duan ta kthejnë përnjëheri dhe në mënyra të ndryshme të vijnë deri te ajo [që kanë humbur], mirëpo nuk mundësh. Më pas këta të cilët janë Beogradas të vjetër kanë të drejtë njerëzit. Çka tash ka

ardhur njëri dhe tash dëshiron të grabis. Nuk mundësh ashtu. Dhe tash njerëzit të mbajnë në distancë. Megjithatë, fëmijët e mi e kanë mirë.

Marijana Toma: Sa vjet i kanë pasur ata kur kanë ardhur?

Sreten Gjuroviq: Ky Lluka është '83-sh, në '99-tën, 16 vjet, e ky i ka pasur njëmbëdhjetë, i vogli, Llazari. Edhe pse ata u adaptuan menjëherë, kjo është megjithatë... edhe pse ky i vjetri pak më vështirë, por ky i vogli ka qenë fëmijë, në klasën e katërt.

Marijana Toma: Menjëherë janë regjistruar në shkollë?

Sreten Đurović: Po, po, menjëherë këtu.

Marijana Toma: Çka punojnë tash?

Sreten Đurović: Paj që të dy punojnë me mu. Kemi punuar ne edhe shpedicion për disa njerëz dhe parvjet ishim 50 000 Eura në minus, për doganë pagova atë, këtë dhe kur shkoja t'i kërkoja paret, "Prit bre, 5000 Euro t'ka kushtu kjo punë". "Paj po 5000 Euro, po ato janë paret e mia". Pesë unë, pesë ti, dhe kështu bankrotuam. Tash e mbajmë këtë kafenenë këtu dhe atë restorantin në Avallë, *Stari Majdan* [Majdani i Vjetër].

Marijana Toma: Dhe kush punon në restoran, ju?

Sreten Đurović: Unë dhe ky djali i vogël, dhe ky i vjetri vjen dhe ndihmon. Ka aty edhe kamarier dhe kuzhinier dhe kështu.

Marijana Toma: Sa është numri i përgjithshëm i njerëzve që punojnë për ju?

Sreten Gjuroviq: Ha... ka shumë që punojnë, të cilët janë të punësuar por punojnë pak. Ka këtu dhjetëra njerëz, dymbëdhjetë, trembëdhjetë njerëz, sa ka këtu dy, tre, katër, gjashtë. Ka dikun 15 – 20 njerëz.

Marijana Toma: Dhe më thuani, deshta të ju pyes... në fakt kur folëm sot ju e përmendët, para kësaj interviste, më treguat që shumë mirë flisni shqip. Këtë e përmendët. Ku keni mësuar shqip?

Sreten Gjuroviq: Më duket që unë nuk flas shqip, unë ëndërroj në shqip. Po e kam mësuar atje me fqinjët dhe miqtë e mi. Kur mësoni diçka aq mirë, do të thotë që e doni. Me dhunë asgjë nuk bëhet, asgjë.

Do të thotë unë gjithnjë kam qenë këtu, atje në fshat, i përzier me fëmijët. Ata e ndërtuan, ndërtuan këtë atje, minaren tek ne në fshat dhe këtu ka qenë njëfarë hoxhe, Mulla Rashid, dhe ai më thotë mua, "Do ta marrin materialin te ti kështu që ta ndërtojmë atje në fund [të lagjes]" "Vetëm merre ti, ne i shënojmë dhe ti m'i jep paret". Dhe erdhën kur përfundoi kjo, dhe ai erdh dhe më tha, "Hajde po i a qesim lapsin". "Hajde", iu them. Thotë, "Sa kushton kjo?" Them, "Asnjëgjë, kjo është pa pare, kur t'shkojsh aty falu edhe për mua".

Marijana Toma: Ju në fakt me materialin tuaj?

Sreten Gjurovic: Po, po unë ju kam ndihmuar aq sa kam mundur, sa kanë qenë mundësitë. Mirëpo, e them që shqip kam mësuar këtu kur kemi ruajtur lopët me këta të mijtë, kemi luajtur futboll, jemi shoqëruar, jemi fyer, grindur, gjithçka kemi bërë, si fëmijë gjithçka kemi bërë.

Marijana Toma: Pas vitit '99, kur keni shkuar për herë të parë në Kosovë?

Sreten Gjurovic: Po unë kam shkuar menjëherë diku mas pesë, gjashtë muaj, një vit.

Marijana Toma: Nuk jeni frikësuar?

Sreten Gjurovic: Jo, unë nuk, nuk kam pasur frikë, pse nuk kam pasur frikë? Askujt asgjë nuk i kam bërë. Shumë njerëz më kanë thënë, "Mos shko!" kjo, ajo. U kam thënë, "Po shkoj e le të më vrasin". Ka pasur shumë probleme, e di e çka? Disa miq me pretendime të rrejshme, iknin prej meje. Mos ik prej meje. Unë prej teje nuk kam ikur kur kanë qenë këta, unë nuk kam ikur.

Kam shkuar dhe shumë njerëz kanë thënë fjalë të pakëndshme për mua. Kam shkuar te njëri në zyre, hajt mos t'ia përmendi emrin, "Hej bre, ku je, çka po bon?" Dhe e përkuli kokën kështu, "Unë jam ai që i ka vlarë fëmijët shqiptarë, unë jam ai. Ku je ti me m'vra mu? Mos fol kështu diçka". Ka shumë prej tyre që janë propagandues të pastër. Dhe më pas ai fillon të flas dhe unë i them, "Jepma arsyen, arsyen. Unë do t'ua them emrat individualisht Marko, Janko, ai dhe ai, ma kanë bërë këtë. Individualisht do ta them. Ndërsa ti? Mos fol kështu".

Kur nuk ke qenë i pranishëm, gjithkrah ka pasur padrejtësi edhe prej njerës dhe tjetrës anë, edhe prej njerës dhe tjetrës. Edhe serbët tanë kanë bërë probleme atje. Pak njerëz kanë menduar që duhet edhe nesër të jetohet aty. Momenti ka ardhur, euforia, mbledh çka mundësh me mbledh, këtë atë, përlulë të tjerët. Të këtij lloji ka edhe prej anës tyre. Prej tyre, po e them për shkak të varrezave, asgjë më shumë s'ka nevojë të flasim. Asgjë më shumë. Turp, e tash ata njerëzit e njejtë kur shkoj "poshtë", "Hej, a mundësh ma ma kry këtë?" "Mundem të gjitha, mundem të gjitha me i kry".

Vijnë këtu nëpër spitale. Çdo ditë i kam, çdo ditë i kam këtu nëpër spitale. Shkoj, i voziti, i kthej, vijnë. Nuk ka ditë që nuk vjen dikush. Do të thotë s'ka ditë. Më pyesin, "Sa t'i kam borxh?" U them, "Drejtoju Zotit, ai do t'më paguaj mua, e ti shihe si do t'ia bësh me të. Ndërsa ti a kishë mujt "poshtë" të njëjtën mu të ma mundësosh?" Edhe tash njejtë nuk kishte mujt. Nuk mundet. Po mendoj, këto janë disa gjëra. Dëshirojnë që t'u ndihmojë, kot, nesër i thërrasin u thojnë pse po punon për të? Prapë je lidhur me serb, *bashkëpunëtor i shkive* [flet Shqip]. E kuptoni? Këto janë gjëra të tmerrshme.

Marijana Toma: Çka ka ndodh me pronën tuaj "poshtë"? Kjo, jeni dashur diçka të shisni apo e keni marrë tashmë?

Sreten Gjurovic: Jo, unë nuk kam mundur ta shes. Nuk kam mundur ta shes. Vëllau i heroit kombëtar, heroit të tyre kombëtar është në pronën time edhe në ditët e sotme.

Marijana Toma: Ka hyrë? Është ai që ka hyrë me dhunë?

Sreten Gjurovic: Ka hyrë me dhunë sepse unë përballë Grandit i kam pasur 200 metra kuadrat. Ai ka hyrë këtu dhe është vendosur dhe i jeton edhe familja, madje është kërcënuar që do të më vrasë. "Ja në Prishtinë jam, më vraj". Ai thotë që unë ia kam vlarë vëllaun. Nuk është e vërtetë. Të gjithë e dijnë kush ia ka vlarë vëllaun.

Marijana Toma: Ai ka thënë për ju që ia keni vrarë vëllaun?

Sreten Gjuroviq: Po. Ilir Konushevc i është hero kombëtar, vëllau i tij është Saimir Konushevc. Dhe ai pa asnjë bazë ligjore përdorë hapësirat e zyreve të mia. Ka ndërtuar mbi hapësirat e zyrës, pa pëlqimin tim, pa asgjë, ajo është e imja. Ai ka ndërtuar këtu dhe tash shteti po e mbron, tash shteti po e mbështet. Turp, turp.

Ka 19 vjet që unë e dëshmoj të vërtetën, ndërsa e vërteta dihet. Ta pyesim atë, “A ke dokumenta për këtë?” “Nuk kam”. “Hajde, jasht!” Unë duhet ta dëshmojë që jam pronari, por ai jo. Kjo është absurde. Mirë, po u ndihmon në këtë edhe bashkësia ndërkombëtare. Po të kishim qenë të barabartë në dhënien e dëshmisë shumë shpejt ishte zgjidhur. Jo, ai me qenë brenda ndërsa unë jasht. Tash njeriut të cilit ia kam shitur edhe ai nuk mundet njëjtë, edhe ai është shqiptar dhe nuk e lejojnë të bartet aty. Nuk e lejojnë ta përdorë pronën e tij. Unë të tijën e përdori këtu, ndërsa atë nuk e lejojnë të hyjë, thjeshtë nuk e lejojnë të hyjë.

Marijana Toma: Këtë e keni shkëmbyer?

Sreten Đurović: Po, unë e kam bërë një shkëmbim me Agim Ukiqin, ai ka shkuar atje “poshtë” dhe ai i shkreti tash dëshmon, tërë kohën dëshmon që është e tija dhe unë kam shkuar me mijëra herë. Ju them, herën e kalume kam paguar 10 000 Euro kam paguar taksat për pronë të cilën nuk e shfrytëzoj, turp, turp. Dhe asgjë, kjo është problem, problem. Nuk jam vetëm unë, ka shumë njerëz me këto probleme.

Nëse kishte dashur dikush të jetë i drejtë dhe real, ulësh në tavolinë. Dorëzoji ti dokumentet e tua, dorëzoji ti tjetri deokumentet dhe kjo do të zgjidhej për një ditë. Për një ditë zgjidhet. Kush do ta dinte më mirë pos atij që do të duhej ta legjitimojë. A e ke letërnjoftimin apo a je banor i kësaj, kësaj. Si? Nëse nuk e ke ekstraktin nga libri i amzës apo nëse nuk je në kadastër, si e dëshmon ndryshe? Si e dëshmon? Pra duhesh me dokumentacion me e dëshmu dhe kjo është e vërteta. E jo, unë tash e dëshmoj ndërsa ai rrin brenda dhe i kënaqet. As nuk paguan rrymën, as ujin, asnjëgjë. Turp, turp.

Marijana Toma: Ndërsa banesën që e keni pasur në Prishtinë, a keni shitur atë?

Sreten Đurović: Unë atë banesë që e kam pasur në Prishtinë, po edhe atë e kam dhënë me kiste. Ai edhe sot ka mbetë, nesër edhe pak dhe përfundon. Paramendojeni, banesë të cilën ia kam dhënë atij njeriut, ai e përkthen pa dijeninë time. Unë tash me qenë i prisht do duhej të shkoj dhe ta dëshmoj që ky nuk është nënshkrimi im. Si e keni përkthyer ju këtë? Tash, mund të jem i prisht edhe të them, “Prit bre, unë këtë nuk e kam shitur.”

Sepse tash i ka mbetur vetëm gruaja, ai ka vdekur, dhe unë të bëhem, të them, “Unë këtë ty nuk ta kam shitur. Ta dërgojmë te grafologu nënshkrimin ta shohim i kujt është”. Kjo është kjo punë. Kjo është diçka që unë nuk mund ta spjegojë. Disa gjëra nuk di t’i spjegojë se si ndodhin atje “poshtë”. Po mendoj këta njerëz, njeri nëse dëshiron të blesh apo të kesh diçka, duhesh që nesër kur të lësh diçka, tash ai njeriu ka vdekur tash unë mund të jem i paftyrë njëjtë sikurse ai që ka qenë dhe të them, “Eh unë këtë nuk ia kam shitur”. Gjë që është e vërtetë, nuk kam kurrfarë dokumente, nuk kam dëshmi. Ai e ka bërë një marrëveshje i cili nuk ka vlerë. Problem, por kjo hecë.

Marijana Toma: A jeni sot në kontakt me ata miqtë e tu?

Sreten Gjuroviq: Çdo ditë, çdo ditë.

Marijana Toma: Jo vetëm me ata të cilëve u kryeni punë, por edhe kështu?

Sreten Gjuroviq: Jo, jo, kështu me njerëz të thjeshtë, shokët e mi me të cilët jam rritur, çdo ditë jam në kontakt me ta. Unë e përdori më shumë gjuhën shqipe në Beograd se sa kur kam qenë “poshtë”. Sepse i thërras ashtu të flasim. Kam mjaft kontakte me shumë njerëz atje dhe në Shqipëri. Shkoj edhe atje shpesh. Interesant është për mua ai popull, e dini çfarë, për mua ai popull është interesant sepse janë shumë të ngjajshëm me neve. Unë atyre u them, “Kush urrehet më së shumti? Më së shumti urrehen dy vëllezër kur grinden.” Unë mendoj që ne i kemi rrënjët e njëjta andaj dhe kemi urrejtje. Dhe është lehtë të gjuash një kockë në mes të vëllezërve dhe ata do ta shfrytëzojnë këtë, këta arkitektë të botës kanë shfrytëzuar këto pakënaqësitë tona dhe më pas na e kanë gjuajtur një kockë në drejtim të gabuar, kjo është katastrof.

Marijana Toma: Deshta të ju pyes diçka për fund. A do të ishit kthyer në Kosovë?

Sreten Gjuroviq: Unë tash në këmbë do të nisesha. Isha nisur tash kisha ecur deri sa kisha arritë. Mirëpo si të kthehem? Dua bre ta di që kur të shkoj në komunë, ambulantë, spital, fakultet dhe [nuk] të thotë *qe ky shka është* [flet shqip], ky është Serb. Paramendojeni tash ata fëmijët të cilët kanë lindur në ‘99, të cilët tash janë 20 vjeç, asnjëri nuk e njih serbishten. Asnjëri, flasin anglisht. Pra edhe këta më të vjetrit të cilët kanë pasur tre, katër, pesë vjet, tash i kanë 25 vjet, ata mbajnë funksione zyrtare, në pozitë, si t’ia bësh me ta?

Gjatë gjithë kohës që bashkësia ndërkombëtare është munduar të krijojë shoqëri ndëretnike, ajo ka ndërtuar vathë. Jetojnë në atë enklavë, në enklavë çka nuk ndodh. T’i izolosh ashtu kjo nuk është ndihmë, nuk është ndihmë. Në jug të Ibri, në veri të Ibri, çka tash, çka do të thotë kjo? Këto janë budallaki të cilat... me qëllim t’i vendosin disa kufij dhe themi tash, erdha sepse më kanë ofruar ta përfaqësojë popullin tim. Si ta përfaqësojë? Çka nëse nesër më thonë unë duhet të shkoj në Drenas, atje askush nuk e njih serbishten. Atje duhesh ta bësh kadastrin i cili ka qenë, atje nëpër Drenicë ka mjaft serb, si do ta bësh? Të duhet përkthyes, të duhet kjo, ajo.

Nuk është kjo, unë e them pasi që unë jam ai që nuk ka kurrëfarë problemi. Unë flas shqip, njoh shumë njerëz të cilët kanë jetuar atje në ato mjedise, nëpër enklava të cilët nuk kanë ditur shqip dhe nuk dijnë as sot e kësaj dite, si do t’ia bëjnë ata? Çka është ai në atë kamp, në atë vath? I duhet ta thërrasë atë fqin, mikun me të cilin ka punuar, “Hajde të lutem më dërgo në Prishtinë ta kryej këtë dhe atë”. Kjo nuk është zgjidhja, kjo është problem, problem.

Dhe kur të dëgjojnë që flet serbisht dhe dikush dëshiron të të ndihmojë, mirëpo ka dikush aty që shikon dhe thotë, “Çka ki?” [në shqip] Prapë ti po ndihmon? Kupton kjo është problem. Dëshirojnë njerëzit, ka njerëz që dëshirojnë të të ndihmojnë, mirëpo tash ai i ardhuri i thotë çka është kjo? Po mendoj, kjo nuk është e shëndoshë. Unë për secilën imtësi duhet ta thërrasë dikë që të shkojë deri te motra ime në Graçanicë, që t’i ndihmojë dikush nga Prishtina.

Ata për gjërat më të thjeshta, për kontrollën më të thjeshtë duhet të shkojnë ose në Mitrovicë, pra kjo është 80 kilometra prej aty ose të shkojnë në Nish ose të vijnë këtu [Beograd]. Këto janë gjëra të papranueshme, të papranueshme që bashkësia ndërkombëtare ka krijuar ndarje të tillë. Keni ardhur,

por mos më ruani, por më afroni me ta. Për 20 vjet ne gjithnjë e më shumë po largohemi, ky është problem, problem.

Projekt, çfarë projekti? Nuk na duhet projekti na jipni punë dhe na paguaj, krijo fabrika, ky është projekti. Asnjë fabrikë nuk e kanë krijuar, asnjë. Bashkësia ndërkombëtare asnjë fabrikë nuk e ka krijuar në Kosovë. Bëje një projekt dhe punëso serbë, *šiptare* e *cigani*⁷ e turq le të punojnë e të gjejnë gjuhë të përbashkët. Romët, mirë nuk ka lidhje, romë, *cigani*, unë i dua *cigani*. Unë di të flas *ciganski*.

Këto janë ato gjëra. Bashkësia ndërkombëtare le të krijojë fabrika atje “poshtë”, le të punësojë dhe ky është fundi i tregimit. Dhe unë aty do të punoj, me atë do të mirrem, me atë do të mirrem. Nuk dua me politikë të mirrem, mirëpo vetëm me punë. Ta krijojmë një fabrikë në Fushë Kosovë, një në Sllatinë, një në Drenas, një atje që të punësojmë njerëz, serb e *šiptare* e *cigani* dhe të gjithë, dhe do të shohës se si do të rregullohet. Kurrë nuk do ta përmendin se ka pasur luftë, kurrë!

Çka, po atij i duhet ta përmend, hanë thonjtë tërë ditën mendon çka u bë me të. Mendon se si do të ikë. 90 përqind kanë pasaporta, i kanë marrë ato serbe për të mundur të shkojnë jashtë. Çka ju ka dhënë bashkësia ndërkombëtare? Vetëm i ka izoluar, vetëm atyre ua ka izoluar pasaportat. Pra të mos i përdorin për ndojgjë, turp, kjo është e turpshme, turp.

E kemi një rast me njërin prej fqinjëve tanë atje. Vajza i është martuar më njërin nga Kosova i cili është në Gjermani, dhe tash ajo nuk mund të jetoj atje me burrin. I duhet ta njohë gjuhën gjermane që të, pasi që kjo është demokracia. Do ta mësojë. Nuk mund ta mësojë këtu, por nga zori do të detyrohet ta mësojë. Kur të shkojë në dugojë ajo do ta mësojë gjermanishten. Jo, i thonë duhet ta dishë nivelin bazik të gjermanishtes. Unë nuk jetoj me gjerman, unë jetoj me shqiptar. Dhe kur të shkoj, fëmija diku një vjet e do ditë, nuk mundet vajza me shku në Gjermani me jetu. Mirë, unë nuk do të përzihem këtu edhe ata i kanë rregullat e tyre, mirëpo kjo nuk është në rregull, kjo nuk është në rregull.

Marijana Toma: A kishit dashur të shtoni diçka për fund?

Sreten Gjurovic: Çfarë të ju them, fund nuk ka. Çfarë të them kur fund nuk ka, fund do të ketë kur të bëhet bukur e këta që po na e sjellin demokracinë të largohen pak, të na lejojnë që ta krijojmë demokracinë vetë, që ne mes veti të merremi vesh, pa mbikëqyrës. Gjithnjë është vështirë kur ka ndërmjetësues. Na lejoni vetë, që të flasim me njëri tjetrin. Unë do të bëja një, një ndryshim të madh do ta bëja në këto punë, mirëpo pa ndërmjetësues, direkt unë do të flisja me ta. Pra mua nuk më duhet përkthyes, gruaja ime është përkthyes. Kisha përkthyer prej serbishtes në serbisht. Këtu njëjtë kemi probleme. Ajo mua ma përkthen atë çfarë djemtë e mi më flasin. E kështu njëjtë edhe bashkësia ndërkombëtare na e përkthen çfarë ne duhet të bëjmë. Ne jemi budallenjë. Këto janë probleme, pra këtu qëndron problemi.

Unë para njëzet ditëve, kam një shok që jeton atje lartë në Prizren, turk është. Ka treqind vjet që mbajnë dele, dhe ne dëgjohemi me telefon dhe më thotë mua, “Becko, shiko nëse ka aty njëfarë rrace Romane të delës”. Unë e gjejë këtë në internet dhe ia blej dy. Unë i marrë ato dhe në veturë Pezho [Peugeot] ia sjell në Gjilan. Dhe ai më thotë mua, “Asgjë më të mirë nuk ke mundur të bësh për mua”. “Pse?” “Nuk ka mundësi më të lumtur të më bësh që m’i ke pru këta dy dashi.” Gjithnjë duhesh të shkosh në doganë, njëri thotë pse po e bjen në këtë anë, tjetri pse po e merr me veti? Të gjitha janë

⁷ Formë derogative e emërimit të romëve.

gjëra që nuk duhet, nuk duhet të ndodhin.

Kjo është mirë që Vuçiqi dëshiron të bëjë këtë pa kufij. Kjo është një gjë e mirë, që uniteti të jetë, kjo është një punë e mirë. Kështu popujt, ekonomia do të afrohen, duke e pasur xhepin plot. Stimulimi më i mirë është kur njeriu ka kënaqësi, kur ka para, ky është stimuluesi më i mirë, ilaqui më i mirë. Dhe të gjithë e kanë mirë. Si nuk kemi para, përralla të thata, më pas të gjithë marrin një sëmundje të pashërueshme, agresivitetin dhe të gjitha. Ky është problemi. Jepni njerëzve punë, ekonominë, dhe të punojnë. Ne do të bëjmë punë, unë do të krijojë punë. Unë po ju them nëse dikush dëshiron të më përdorë mua dhe miqtë e mi që të bëj diçka atje, dhe le ta shoh se për sa shpejt do të punoj unë atje. Mirëpo vetëm përmes punës, përmes punës dhe jo përmes përrallave të thata, përmes punës. I punëson 20 njerëz.

Po themi, tash ka verë atje në Rahovec. Njerëzit po bëjnë verë të cilësisë së lartë, të cilësisë së lartë. Ja pra të ua tregoj bocën, verë e cilësisë së lartë, dhe ai këtë verë e cila kushton poqëse do të ishte paketuar mirë do të kushtonte dhjetë euro. Ai këtë e shet për dy euro, euro, gjynah. Dikur kjo “Verë Kosove” në territorin e Beogradit është shitur deri në pesë milion litra. Tash nuk mundet as pesë litra të i shes. Pra kjo është diçka që mund të përmirësohej.

Këto janë ato gjëra të cilat na bëjnë të harrojmë të gjitha ato që i kemi pasur. Dhe të gjitha mirë na vijnë. Ka të holla për të arsimuar fëmijët, ka të holla ta renovojë vneshtën, që ta përparojë atë që këto gjëra t’ia garantojnë të ardhmen, të cilat ia garantojnë një jetë të mirë, asgjë më shumë nuk i duhet. Secilit prej nesh asgjë më shumë nuk i duhet. Ballkani është një vend ku të gjithë shkruajnë projekte në dëmin tonë, kjo është problem. Ky është një problem shumë i madh. Ka edhe shumë të tjera.

Po themi, më vjen keq që nuk kam mundësi t’ua tregoj, bash ai turku Nehar Skenderi, ai më ka dhënë një recept të prodhoh djathin e Sharrit, mirëpo herën tjetër kur të vini atë do t’ua maroj. Të shihni se çfarë prodhimi është ai. Atë kur ta shijoni, sikur të shkrihet në gojë. Shumë gjëra të tilla ka aty, shumë ka gjëra atje “poshtë” që janë interesante për jetë, për punë, për biznes. Ka shumë njerëz që kanë punuar këtej nëpër Serbi, shumë ka bukëpjekës dhe sot e asaj dite janë këtu. Ka shumë punëtorë të ndërtimitarisë në “Niemar” në “Ratko Mitrovic”, në “Trudbenik” në të gjitha këto kompani. Të gjithë këta njerëz do të vinin të punonin. Atje “poshtë” pret puna. Hanë thonjtë, fëmijët e pakënaqur, familja shpartallohet, anej, knej.

Po thotë bash ky miku im Ramadani nga Vuçitërna, i cili ka njëmbëdhjetë vëllezër dhe shtatë motra, para 15 vitesh kishte rrahur gruan, e kishte shuplakuar gruan. Kjo nuk është në rregull, nuk e mbështes këtë dhe polici gjerman, amerikan banon ndër të dhe ai e kishte lajmruar në polici. Vjen policia dhe e dërgojnë në stacion të policisë. Më thotë, “Unë nuk kam pasur problem me shtet, mirëpo me këto organizatat joqeveritare. Gratë në të zeza, Gratë në të Bardha”.⁸ Gratë janë sa treqind dreqën. E kishin pyetur, “Pse e keni goditur, ku e keni pasur mospajtimin?” Ai iu thotë, “Po të ishim pajtuar, unë nuk e kisha goditur. E dini? Ndërsa problemin më të madh e kam që ju nuk investoni [në ekonomi] që ne mos të kemi mospajtime”. Kjo ishte përgjigjja e tij. Skamja na detyron të kemi mospajtime, ndërsa organizatat joqeveritare të cilat merren me thashetheme...

Të merremi me punë, punë. Kjo është zgjidhja e të gjitha problemeve. Vetëm puna, ekonomija, kjo i perfekcionon të gjitha. I gjithë Ballkani, prej Sllovenisë, mirë Sllovenija, prej Kroacisë poshtë deri te,

⁸ Gratë në të zeza - *Žene u crnom*, janë organizatë joqeveritare feministe dhe kundër luftës. Gratë në të bardha nuk ekzistojnë, folësi po i karikon.

te, te Greqia. Vetëm punë, këtë na e jipni njerëz, mos i mbyllni të hollat dhe të na i jipni me lugë sikur atij në buzë të vdekjes, të sëmurit që i jep tableta. Na jipni të punojmë, na punësoni. Mos na detyroni të merremi me politikë, pasi që ne nuk jemi për politikë. Ne jemi për prashitje [punë], me të vërtetë.

Ja edhe këtë që po e xhironi nuk jam e sigurt sa ka efekt. Kush do ta shikojë dhe ku do të shfaqet kjo? Po ju them nëse ka njerëz të cilët do të ndëgjojnë dhe nëse dikush dëshiron suksesin e këtij emision, të na kontaktojnë, na jipni punë. Vetë na jipni këtë dhe do t'i shihni rezultatet. Vetëm të shihni çfarë zotërinj jemi ne kur e kemi xhepin plot të holla. I dijmë ne edhe xhaketat Boss⁹ t'i veshim dhe të mbajmë kollare të bukura. E tash shkojmë dath e deshë dhe fëmijët na mirren me gjëra jo të natyrshme. edhe vajzat edhe djemtë. Nuk jam unë kundër asnjëgjëje që është bashkëkohore.

Megjithatë, i shikoj të gjitha këto gej parada, po kjo është një budallaki. Ai mua më tregon çfarë bën, çka më intereson mua çka ai bën? Edhe unë i bëj të gjërat e mia por nuk të tregoj. 364 ditë jeton dhe punon dhe tash në ditën e 365 thua unë duhem me atë. Duaju tutje askush nuk të pengon. Cili prej tyre ka pasur problem sepse dikush e paska sulmuar? Ja vijmë këtu tek unë në kafe dhe poshtë në kafene. Unë i shoh tekta puthen, çka më intereson mua, ajo është jeta e tyre. Mirëpo ata dojnë që me dhunë të na dëshmojë që ai është i tillë, po edhe unë jam ky. Tash ne që jemi 99 për qind të cilët jetojmë jetë normale, ne nuk tregojmë që bëjmë dashuri me gra.

Ju qenkenit të bekuar, po shuani... duhet të lindni. Çka nëse ju [i drejtohet intervistuesës] do ta bënit me një grua, a do të lindnit, kurrë! Disa gjëra na i imponojnë të cilat janë të panevojshme, të panevojshme. Të pavlefshme, të pavlefshme. Edhe më parë ka pasur njerëz të tillë, homoseksualë, ka pasur, askush nuk u ka bërë gjë, as nuk janë vërejtur. Ka qenë e ditur. Unë e di, që thojnë për këta gjakovarët, thojnë për ta që janë... gjithnjë është thënë që ata janë homoseksualë. Ne që pesëqind vjet kemi {tregon me duar} të më falni por kurrë nuk e kemi pasur SIDA-n. Të gjithë këta na bënë SIDA-n, tash edhe ne po frikësohemi. E prodhuan një sëmundje.

Këto janë budallaki. Gjëra të tmerrshme po ndodhin. Nuk e di nëse kjo do të jetë mirë për ndonjëri. I them unë djalit tim, i cili nuk po martohet, i ka 34 vjet, "Mos ke ndonjë djal bre, e sjell edhe atë". Çka tash? Po mendoj me të vërtetë është e panatyrshme, është e panatyrshme të na i imponojnë disa gjëra. Imponojnë, po tregoj që gruaja përkthen për mua. E them, tejet e panatyrshme. Nuk e di çfarë të bëj me fëmijë, nuk punojnë. Na duhet vetëm punë, punë, punë.

Unë në vitin '73 ka vozitur mini moris¹⁰, '73-tën!! Edhe në Angli kur është prodhuar rrallë kush e ka vozitur. Unë e kam pasur të ri. Kam fituar, kam pasur rrogën 2000 Marka. Djali i axhës sim ka punuar në Gjermani dhe e ka pasur rrogën 1500 Marka. Ai ka punuar për Mercedesin¹¹, dy duar dhe dy shrafa tërë ditën dhe ka vënë shrafa në mënyrë automatike. Unë i kam pasur 3000 Marka, kam pasur mini moris, rroba, dhe kam udhëtuar.

Në Greqi kam qenë për herë të parë në vitin '74, kam shkuar ta servisoj mini morisin. A e din çka kemi qenë ne për grekët? Amerikë. Ata nuk kanë pasur as banane, as këtë, as ate. Unë merrja me veti një mijë e diçka dollarë, kjo është shumë, shumë. Po mirë me shpresë që Zoti do të ndihmoj e që të ndërrojnë gjërat. Apo dikush ta dëgjojë bisedën tonë dhe të thotë, "Po, prit të shohim e të fillojmë të

⁹ Hugo Boss, shtëpi gjermane e modës, e njohur për veshjet luksoze të burrave.

¹⁰ Mini moris, brend i veturës së mirënjohur britanike.

¹¹ Mercedes, brend i veturës së mirënjohur gjermane.

punojmë, që të mos merremi me politikë, mirëpo të punojmë dhe të shohim nëse do të qetësohen ata “poshtë”. E unë po ju garantoj se do ndodh. Unë garantoj se do të ndodh.

Marijana Toma: Super. Shumë faleminderit.

Sreten Gjurovic: Faleminderit shumë që keni ardhur dhe le të jetë kjo ftesë për një jetë më të mirë, dhe dhashtë Zoti të na dëgjojë dikush dhe të na ndohmojë ta realizojmë këtë.

Marijana Toma: Unë po shpresoj.

Sreten Gjurovic: Paj, po nuk ishte shpresa. Dita më e bukur e jetës është ajo... a e dini se cila është?

Marijana Toma: Jo.

Sreten Gjurovic: Nesër. Dita më e bukur e jetës është nesër. Çdo ditë, nesër, nesër.

Marijana Toma: Shumë faleminderit.

Sreten Gjurovic: Faleminderit edhe juve!

